



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**V E N D I M**

**Nr. 131, Datë 04 / 12 / 2017**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 92, datë 03.08.2017, e bërë nga F.Y<sup>1</sup>, kundër OSHEE Berat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “Racës”.

Institucioni i Komisionerit gjatë takimeve të zhvilluara në Bashkinë Berat, në kuadër të aktivitetit “Ditë të hapura”, ka administruar disa ankesa lidhur me sjelljen dhe trajtimin e personave të komunitetit Rom dhe Egjiptian nga ana e subjekteve publike dhe private në Bashkinë Berat. Një nga këto ankesa është në emër të shtetases F.Y.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues informon Komisionerin se jeton së bashku me bashkëshortin dhe djalin vetëm me një pension 16.000 lekë. Bashkëshorti është i sëmurë me diabet dhe ka pasur ndërhyrje kirurgjikale duke i prerë gishtin. Në këto kushte nuk ka pasur mundësi të paguajë faturën e energjisë për shkak se fatura është shumë e lartë dhe OSHEE që nga muaji shkurt i ka ndërprerë furnizimin me energji. Ankuesja kërkon që të ulet tarifa e pagesës në 2800 lek, pasi ka në përdorim në shtëpi vetëm një televizor.

Diskriminimi për shkak të racës është një nga shkaqet për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me racën dhe gjendjen shëndetësore.

<sup>1</sup> Ankuesja i përket komunitetit rom të qytetit të Beratit.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 787/1 prot, datë 23.08.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga ana e OSHEE Berat, lidhur me ankesën e bërë nga F.Y.

Me shkresën nr. 2001/1 Prot, datë 07.10.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të administruar tek Komisioneri me nr. 787/2 prot, datë 11.10.2017, OSHEE Berat, informon se: “Për rastin e F.Y nuk kemi asnjë të dhënë për adresën e saktë apo emrin e saktë me të cilin faturohet pasi në sistemin e faturimit nuk ekziston asnjë abonent me emrin F.Y”.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr.133, datë 06.10.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit në Drejtorinë Rajonale të OSHEE Berat”, inspektorët e KMD-së me datë 11.10.2017 u paraqitën pranë OSHEE Berat, me qëllim marrjen e informacionit dhe kryerjen e verifikimeve përkatëse, lidhur me ankesën e F.Y.

Gjatë inspektimit, G.K me detyrë, Shef i Degës së Shitjes dhe Arkëtimeve pranë OSHEE Berat, informoi se F.Y nuk identifikohet në sistemin e OSHEE, për këtë arsye duhet që ankuesja apo mbajtësi i kontratës të paraqitet pranë shërbimit të klientit dhe të bëjnë kërkesë, dhe nëse plotësohen kushtet do bëhen dhe veprimet e nevojshme për riskedulimin e kësteve të pagesës së prapambetur.

Me e-mail, datë 02.11.2017, të dërguar nga, G.K me detyrë, Shef i Degës së Shitjes dhe Arkëtimeve pranë OSHEE Berat, informohet Komisioneri se punonjësit e OSHEE kishin kontaktuar me F.Y të cilën e kishin udhëzuar për kushtet dhe dokumentacionin që duhej të plotësohej për përfshirjen në skemën e pagesave të detyrimeve të prapambetura për kategorinë “pensionistë”. Pas dorëzimit të dokumentacionit në zyrën e Kujdesit për Klientin nga ana e F.Y, u realizua dhe ndryshimi i kushteve të aktmarrëveshjes së mëparshme nga 2500 lek në 1200 lek në muaj.

**Për sa më sipër, gjatë procesit të hetimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ankuesi dhe palës kundër së cilës drejtohej ankimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi:**

Sipas informacionit të administruar, ankuesja F.Y për shkak të gjendjes ekonomike dhe gjendjes shëndetësore të bashkëshortit të saj ka pasur vështirësi financiare në vazhdimin e pagesave të faturave të konsumit të energjisë elektrike sipas parashikimeve të kontratës BE1A..... të lidhur në datë 04.05.2015 mes OSHEE dhe klientit K.H.

Gjatë procedurave hetimore dhe nga informacioni i administruar<sup>2</sup>, Komisioneri, mori dijeni se situata problematike e krijuar, lidhur me ndryshimin e skemës së pagesës së detyrimeve të prapambetura të faturave të konsumit të energjisë elektrike në F.Y, është zgjidhur dhe nuk ekziston më.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se me veprimet e kryera nga OSHEE Berat, problematika e F.Y, është zgjidhur dhe vlerëson se u arrit qëllimi për të cilin është nisur ky hetim në drejtim të lidhjes së marrëveshjes për pagesën me këste prej 1200 lekësh të detyrimeve të prapambetura ndaj OSHEE nga familja F.Y.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gjerat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Ndërprejjen e procedurave të hetimit dhe pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 92, datë 03.08.2017, të F.Y, pasi u arrit dhe qëllimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

**KOMISIONERI**

<sup>2</sup> Email datë 02.11.2017 të OSHEE Berat dhe Mandat arkëtimi datë 02.11.2017 për pagesat e kësteve 1200 lek në muaj.